



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:018998

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05747224

KPPP.nr.290/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës në Prishtinë - Inspektori i Punës në Prizren, me seli në Prizren, kundër debitorit “BENAF”, - Njësia nr.3, me seli në rr. “ Brigada 123”, në Suharekë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Aktvendimit Përmbartimor E.nr.1161/12 të datës 12.12.2012, të Gjykatës Komunale në Suharekë, jashtë seancës, me datën 28.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË si i pa afatshëm prapësimi i debitorit “BENAF”, i paraqitur kundër Aktvendimit Përmbartimor E.nr.1161/12 të datës 12.12.2012 i lejuar nga Gjykata Komunale në Suharekë.

A r s y e t i m

Gjykata Komunale në Suharekë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës në Prishtinë - Inspektori i Punës në Prizren, ka caktuar aktvendimin për përmbartim E.nr.1161/12 të datës 12.12.2012, duke lejuar përmbartimin në bazë të vendimit të plotfuqishëm të inspektorit të punës në Prizren Nr.24/2012 të datës 19.03.2012 me të cilin ka obliguar debitorin që në afatin ligjor t’ia paguaj kreditorit shumën prej 5,000.00 €, me bllokimin e llogarive bankare të debitorit, ose përmbartimi të bëhet nga sendet e luajtshme që gjenden tek debitori, deri në bartjen e shumës së lartcekur.

Debitori në prapësimin e paraqitur me datë 08.03.2013, ka deklaruar se propozimi për përmbartim i kreditorit i lejuar sipas aktvendimit të lartcekur është i parregullt dhe se debitorit i

mungon legjitimiteti pasiv në këtë çështje juridike. Më tutje ka shtuar se në rastin konkret nuk plotësohen kushtet që të ekzekutohet aktvendimi kontestues, për shkak se debitori ka ushtruar padi për anulimin e aktvendimeve të kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të shfuqizohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë (ish Gjykata Komunale në Suharekë), si dhe të ndërpriten të gjitha veprimet procedurale, ose të pezullohet lënda deri në vendosjen meritore nga Gjykata Supreme e Kosovës sipas padisë së debitorit.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se prapësimi i debitorit është i pa afatshëm për arsyet si në vijim:

Nga shkresat e lëndës rezulton se debitori aktvendimin për përmbarim E.nr.1161/12 të datës 12.12.2012, e ka pranuar me datën 28.02.2013, e cila vërtetohet nga fletëdërgesa për dorëzim personal që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është ushtruar me datën 08.03.2013.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se *“Prapësimi duhet t’i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrin përmbarues”*, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”*

Andaj duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret, debitori aktvendimin për përmbarim E.nr.1161/12 të datës 12.12.2012 e ka pranuar me datën 28.02.2013, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 01.03.2013, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 07.03.2013.

Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 08.03.2013, e cila vërtetohet nga vula e pranimit - protokollit nr. 723, të Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Suharekë, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me një (1) ditë vonesë.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata konform nenit 73 par. 3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.290/23, datë 28.05.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.